

Të bashkuar për demokraci, të drejta të njeriut, dhe sundim të ligjit

Deklarata e Vjenës mbi ballafaqimin me autoritarizmin

8 prill 2022

Ne, studiuesit, aktivistët dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile të nënshkruar më poshtë:

Riafirmojmë zotimin tonë për mbrojtjen e vlerave evropiane dhe ndërtimin e një kornize të fortë për shoqëritë demokratike më të qëndrueshme të bazuara në sundimin e ligjit në Ballkanin Perëndimor, BE dhe më gjerë në Evropë.

Riafirmojmë zotimin tonë ndaj nenit 49 të Traktatit të Bashkimit Evropian dhe politikës së zgjerimit të BE-së që e hap anëtarësimin e plotë në BE për të gjitha shtetet evropiane që i respektojnë vlerat e BE-së dhe zotohen për t'i promovuar ato.

Rikujtojmë dhe mbështesim [Letrën e Hapur](#) të datës 16 mars 2022, të lëshuar nga disa prej institucioneve të përfshira lidhur me pushtimin e Ukrainës nga Putini dhe implikimet për Ballkanin Perëndimor.

Vijmë në përfundim se tendenca në rritje e autoritarizmit në fushën e zgjedhjeve paraqet kërcënim të përbashkët për Evropën. Efekti i përmbysjes së demokracisë dhe i cenimit të sundimit të ligjit nuk kufizohet në nivel kombëtar apo rajonal, por është një kërcënim i përbashkët për të ardhmen e Evropës. Prandaj, Evropa duhet të përgatitet që të përballet me sfidën e frikshme dhe të punojë e bashkuar.

Paralajmërojmë se fitorja e fundit e zgjedhjeve nga Viktor Orbán në Hungari dhe Aleksandar Vučić në Serbi ishte shenjë e qartë se demokracia evropiane, siç e njohim, vazhdon të jetë nën sulm. Të dy liderët e kanë minuar demokracinë në shtetet e tyre gjegjëse përmes kapjes së institucioneve shtetërore, tkurrjes së mediave të pavarura, mbylljes së gojës së opozitës dhe pengimit të sundimit të ligjit dhe shtypjes së të drejtave themelore.

Rikujtojmë tendencat e ngjashme alarmuese që mund të vërehen në Poloni, Bosnje dhe Hercegovinë dhe – ndonëse në masë më të vogël – në vende të tjera evropiane. Rusia dhe Bjellorusia tanimë duhet të konsiderohen si diktatura shtypëse.

Paralajmërojmë se me ndjenjat pjesërisht të forta pro-ruse dhe me forcat politike të spikatura pro-ruse në disa prej vendeve të mundshme anëtare të BE-së në të ardhmen, po rritet rreziku i ekspozimit ndaj ndikimit të mëtejshëm keqdashës rus për Ballkanin Perëndimor dhe fqinjët e BE-së në lindje.

Po vëmë re me shqetësim se qytetarët e Bosnjë-Hercegovinës po e shënojnë 30-vjetorin e fillimit të luftës duke përcjellë me një ndjenjë të madhe frike pushtimin rus të Ukrainës. Separatisti serb i Bosnjës, Milorad Dodik, ka thëlluar përçarjet etnike, duke kërcënuar me shpërthime dhe duke rrezikuar me shpërthimin e një konflikti të ri në vend, duke e bërë kështu Bosnjën dhe Hercegovinën kërcënim për paqen dhe sigurinë për tërë rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe më gjerë. Duke e ilustruar faktin se edhe pse e ndaloi luftën në vitin 1995, Marrëveshja e Paqes e Dejtonit kishte dështuar të sillte një shtet shumë-etnik stabil, funksional, liberal, të bazuar në sundimin e ligjit dhe të begatë që siguron përfaqësim të barabartë për të gjithë qytetarët.

Rikujtojmë se Bashkimi Evropian që themeluar, pikë së pari, për të kapërcyer ksenofobinë, nacionalizmin dhe autoritarizmin. Integrimi ekonomik që parashikuar si një nga mjetet për ta ngritur në shkallë më të lartë bashkëpunimin mes shteteve demokratike. Karta e të Drejtave Themelore e BE-së riafirmoi mbështetjen evropiane për të drejtat universale, si dinjiteti njerëzor, liria, siguria dhe solidariteti.

Rizotohemi se do ta mbrojmë demokracinë dhe sundimin e ligjit nga kërcënimet autokratike që po i sillen vërdallë Evropës për një kohë tepër të gjatë, ndër të tjera, duke kuptuar se forcimi i autokratëve pjesërisht ka ardhur si pasojë e nënvlerësimit të përhapur gjërisht të fuqisë së aleancës mes tyre.

Zotohemi se do të kërkojmë dhe do të ndërtojmë aleanca me aktivistë, organizata dhe institucione që ndajnë të njëjtat mendime dhe do të ofrojmë mbështetje për organizatat e tjera të shoqërisë civile që janë të përkushtuara ndaj standardeve të larta demokratike dhe sundimit të ligjit bazuar në vlerat e BE-së siç përcaktohet në nenin 2 të Traktateve të BE-së.

Zotohemi se do t'i dyfishojmë përpjekjet tona në mbrojtjen e vlerave evropiane, ndër të tjera, duke monitoruar dhe ekspozuar nga afër qeveritë dhe liderët që paraqesin kërcënim për demokracinë.

Lavdërojmë Komisionin Evropian dhe Parlamentin Evropian për marrjen e iniciativës dhe përkushtimin e tyre për gjetjen e mënyrave për ta mbrojtur Kartën e të Drejtave Themelore të BE-së që të mos shkelet nga shtetet anëtare. Mbështetja dërrmuese në Këshill dhe jurisprudencën e Gjykatës Evropiane japin arsye për të qenë shpresues.

U bëjmë thirrje institucioneve të BE-së dhe shteteve të saj anëtare që të veprojnë me vendosmëri në zbatimin e të drejtave themelore në vendet e veta anëtare si dhe në vendet candidate. Duhet të vendosen mekanizma të paralajmërimit të hershëm në mënyrë që palët e interesuara të reagojnë në fazë të hershme dhe me politika të përshtatshme porsa regjimet subversive të fillojnë konsolidimin e pushtetit në mënyrë sistematike.

Riafirmojmë se mediat e lira dhe të pavarura janë element thelbësor i një demokracie funksionale dhe një nga shtyllat e Kartës së BE-së për të Drejtat Themelore.

Paralajmërojmë se në rastin e Ruisë rruga drejt sistemit totalitar dhe luftës pushtuese ka kaluar përmes kontrollit të plotë të mediave dhe të mesazheve. Prandaj, në luftën kundër regjimeve autoritare, përpjekjet për ta çmontuar kontrollin e tyre të plotë të peizazhit mediatik luajnë një rol vendimtar.

I bëjmë thirrje BE-së që ta marrë më seriozisht konkurrencën në sektorin e medias edhe nëse një pjesë e madhe e këtij sektori është i paarritshëm për BE-në për shkak të kufizimeve ligjore dhe faktit se operacionet mediatike janë më shumë të organizuara në nivele shtetërore ose rajonale. Për shembull, BE-ja duhet ta konsiderojë konkurrencën në sektorin e medias si tregues të rëndësishëm të ekonomisë funksionale të tregut të lirë dhe të krijojë mekanizma ku shkelja e lirisë së medias të identifikohet dhe të ketë reagim të duhur ndaj saj. Për më tepër, një fushatë ndërjegjësuase për rëndësinë e këtyre lirive në luftën kundër autoritarizmit është më se qenësore.

I bëjmë thirrje BE-së që të sajë një strategji të dyfishtë për t'i luftuar regjimet autoritare në Ballkanin Perëndimor. Strategjia e tillë duhet të përfshijë një ofertë me hapa konkretë, të prekshëm dhe të realizueshëm për integrimin e rajonit me BE-në, në të njëjtën kohë duke e kushtëzuar këtë me përkushtimin e qartë nga vendet candidate ndaj vlerave të BE-së, përfshirë këtu sundimin e ligjit dhe demokracinë. Vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet zgjedhjeve të ndershme dhe të lira, pluralizmit politik, sundimit të ligjit, ndarjes së pushteteve, mediave të pavarura dhe të lira dhe pasjes së një shoqërie civile energjike.

U bëjmë thirrje shteteve anëtare të BE-së që t'i marrin parasysht me seriozitet idetë dhe propozimet për hapat integruar të rajonit në BE, hapa që diskutohen në komunitetin e ekspertëve dhe mes politikanëve të rajonit. Këto propozime, të kombinuara me plotësimin e kushteve rigoroze që lidhen me vlerat e BE-së, do të çonin në shpërblimin e vendeve të rajonit, politikanët dhe qeveritë e të cilave kanë treguar përkushtim të qartë ndaj vlerave të BE-së.

Kërkojmë që shtetet anëtare të BE-së t'i fillojnë menjëherë negociatat me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë dhe që qytetarëve të Kosovës t'u lejojnë mundësinë e udhëtimit pa viza. Me një strategji të tillë të dyfishtë dhe me hapa të menjëhershëm e që janë të vonuar në lidhje me Maqedoninë e Veriut, Shqipërinë dhe Kosovën, BE-ja do të jetë në gjendje ta rifitojë kredibilitetin, t'i japë fund pavendosmërisë aktuale në disa prej vendeve ku përkushtimi ndaj vlerave të BE-së nuk është i pranishëm dhe kësisoj ta çojë rajonin përpara.

Nënvizojmë se me sfidat ekonomike dhe sociale në mbarë kontinentin, që po vijnë si pasojë e pandemisë globale dhe pushtimit të Ukrainës, demokracitë dhe shoqëritë që bazohen në sundimin e ligjit do të jenë nën një presion edhe më të fortë për të treguar se ato mund t'u ofrojnë shoqërive të tyre standarde jetese, mundësi ekonomike dhe shërbime funksionale më të mira. Tani më, liderët populistë në mënyrë agresive po përhapin propagandën se Evropa bazohet në hipokrizi dhe se askush nuk kujdeset për njerëzit e tyre përpos liderëve të fortë. Kjo e bën edhe më urgjente se kurdoherë më parë qëndrimin e BE-së ndaj Ballkanit Perëndimor dhe anëtarëve të saj që shkelin vlerat e BE.

Nënvizojmë rëndësinë e bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet BE-së dhe Këshillit të Evropës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, demokracisë dhe sundimit të ligjit në Evropë. Kosova duhet të bëhet anëtare e plotë e Këshillit të Evropës dhe kësisoj t'u mundësojë qytetarëve të saj, përfshirë pakicave, qasje në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe në të gjitha mekanizmat e të drejtave të njeriut që janë pjesë e sistemit të Këshillit të Evropës.

Zotohemi se do të avokojmë për multilateralizmin dhe institucionet shumëpalëshe dhe do t'i mbrojmë ato, si dhe bashkëpunimin rajonal. Rendi liberal botëror dhe, rrjedhimisht, vlerat evropiane, kanë rezistuar për shkak të rrënjës së tyre në sistemin shumëpalësh dhe në bashkëpunimin global. Siç vërehet herë pas here, liderët autoritarë nuk i rrënojnë institucionet demokratike, por i përdorin ato në avantazhin e tyre nëpërmjet përhapjes së kontrollit dhe alternativave gjymtuese. Andaj, demokracia liberale mund të ruhet duke forcuar institucionet ekzistuese shumëpalëshe dhe duke e riorganizuar bashkëpunimin.

Rikujtojmë se për t'u ballafaquar me kërcënimin nga autoritarizmi dhe përfshirë në zgjidhjen e konflikteve në shoqëritë e përçara, bazuar në faktorë të tillë si rural-urban, lindje-perëndim, gjëra si kombësitë dhe feja, është e rëndësishme të punohet me aktorë lokalë dhe të mbështeten forcat e ndryshimit në terren duke aplikuar qasjen nga poshtë-lart dhe duke krijuar rrjete formale dhe joformale. Në këtë kuptim, prioritet është mbështetja e mbrojtësve dhe e aktivistëve të të drejtave të njeriut që luftojnë për të drejtat e tyre si dhe lehtësimi i rrugës për ata që kanë nevojë për mbrojtje të menjëhershme.

I bëjmë thirrje BE-së që ta ngrisë në shkallë më të lartë politikën e jashtme dhe atë të zgjerimit të bazuar në vlera. Si e tillë, shkelja flagrante e të drejtës ndërkombëtare dhe e normave të saj duhet të dënohet gjithnjë dhe duhet të mbrohet cenimi i vlerave evropiane nga regjimet autoritare. BE-ja, si fuqi normative, do të duhej të udhëheqë me forcën e shembullit, duke i mbështetur demokracinë, promovimin e të drejtave të njeriut dhe shoqërinë civile në ndërtimin e një sistemi të fortë dhe të qëndrueshëm.

Mirëpresim punëtorinë me temën "Si të ballafaqohemi me kërcënimin nga autoritarizmi? Evropa pas zgjedhjeve në Serbi dhe Hungari – dhe më tutje", që u mbajt në Vjenë prej 6 deri më 8 prill 2022 dhe zotohemi që të vazhdojmë me më shumë aktivitete të intensifikuara në kuadër të BE-së dhe Ballkanit Perëndimor.

E hapim këtë Deklaratë për nënshkrues që vijnë nga shoqëria civile në Ballkanin Perëndimor, BE-ja dhe Evropa më gjerë.

Në Vjenë, më 8 prill 2022

Shtojcë:

Menjëherë pas finalizimit të *Deklaratës së Vjenës mbi Ballafaqimin me Autoritarizmin: Të Bashkuar për Demokraci, të Drejtat e Njeriut dhe Sundimin e Ligjit* vëren se zgjedhjet parlamentare në Slloveni të 24 prillit sollën ndryshimin politik kundër populizmit të krahut të djathtë dhe me fokus në vlerat liberale, pro-demokratike, pro-evropiane dhe ekologjike.

Më 10 dhe 24 prill, Emmanuel Macron u rizgjodh në zgjedhjet presidenciale dhe e mposhti lideren e krahut të djathtë Marine Le Pen. Macron fitoi me 58.5% të votave.